

JEPJA SHANSËN GRUAS NË POLITIKË

përmes pozitave udhëheqëse



Janar, 2019
Prishtinë

JEPJA SHANSËN GRUAS NË POLITIKË

përmes pozitave udhëheqëse

Janar, 2019
Prishtinë

Ky publikim është përgatitur me përkrahjen e Fondacionit Konrad-Adenauer, zyra në Prishtinë.

Përgatitur nga:



Përkrahur nga:



Autor:
Jetmir Bakija

Bashkautore:
Arta Sejdiu

Copyright © 2019. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Democracy Plus dhe Konrad Adenauer Stiftung. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+. Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Konrad Adenauer Stiftung.

PËRMBAJTJA

Përbledhja e Analizës....4

Pse gratë në politikë?.....5

Poste të Emëruara6

- Qeveria e Kosovës.....6
- Qeveri Komunale.....9

Poste të Zgjedhura13

- Nivel Qendror.....13
- Nivel Lokal.....14

Poste Partiake16

- Nivel Qendror.....16
- Nivel Lokal.....18

Sfidat e Përfaqësimi të Gruas.....19

- Kandidimi për Zgjedhje.....19
- Financimi i Fushatës.....20
- Struktura të Dominuar nga Burrat.....21
- Përshtypjet Shoqërore.....22
- Obligimet Familjare.....23

Zgjidhja për Përfaqësim

Gjinor në Poste të Emëruara.....25

- Poste të Emëruara në Kabinet Qeveritar.....25
- Poste të Emëruara në Drejtori Komunale.....25

Anekset.....27

- Gratë e Emëruara në Kryesinë e Kuvendit..27
- Shefet e Grupeve Parlamentare.....27

Bibliografia.....28

Përbledhje

Kur flitet për përfaqësimin gjinor në procese politike në Kosovë, aty dominon tema e kuotës gjinore prej 30% në institucione ligjvënëse, në nivel lokal dhe qendror. Kuota gjinore në institucione ligjvënëse përdoret si arsyetim që gratë kanë mjaftueshmë hapësirë në politikë dhe se Kosova s'mund të bëjë më shumë se kaq.

Megjithatë, kjo analizë e shtjellon përfaqësimin gjinor në politikë përtej institucioneve ligjvënëse. Këtu analizohet hapësira e përfshirjes në degë ekzekutive, në pozita emëruese në degët ekzekutive, ku vendimmarrja dhe pushteti është më i madh, sidomos në Kosovë, si dhe përfaqësimi gjinor në parti politike të cilat janë përgjegjëse për emërimin e personave në këto poste politike. Më tutje, kjo analizë e politikës publike ofron propozime konkrete për avancimin e politikave të përfaqësimit gjinor në degën ekzekutive në nivel qendror dhe lokal. Inkurajuese në këtë kohë janë se së pari, ka mjaft hapësirë në degë ekzekutive, në dy nivelet, për të avancuar përfaqësimin gjinor dhe së dyti, Kosova aktualisht është në fazë të shqyrtimit të legjisacionit i cili mund të ndikoj në këtë drejtim.

Në këtë analizë mund të gjeni nivelin e përfaqësimit gjinor në degën ekzekutive të Qeverisë së Kosovës dhe konkretisht në tri poste udhëheqëse për të cilat përzgjedhja varet plotësisht nga partia dhe strukturat udhëheqëse të partisë: postet e zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave. Njëkohësisht, kjo analizë zbërthen emërimet e subjekteve politike brenda koalicioneve, që është faktor i rëndësishëm në adresimin e përfaqësimit gjinor në këtë degë të qeverisë. Ndërsa në nivel komunal, analizohet përfaqësimi gjinor në drejtori komunale dhe nominimet e partive për të parin e komunës, si dhe emërimet e partive për nënkyriyetarë të komunave dhe kryesues të kuvendeve komunale. Pastaj, analiza zbërthen përfaqësimin gjinor në subjektet politike kryesore në vend pasi këtu edhe fillojnë problemet që kanë të bëjnë, me përfaqësimin gjinor në degë ekzekutive dhe poste tjera emëruese. Përpos trupave të kryesive të partive dhe këshillave drejtues si trupa vendimtarë për delegim të zyrtarëve partiak në poste udhëheqëse, kjo analizë shtjellon edhe degët e partive dhe gjendjen e përfaqësimit gjinor në këtë nivel.

Të gjeturat në këtë analizë tregojnë për një gjendje aspak të mirë të përfaqësimit gjinor në pozita udhëheqëse politike, por shpesh herë faji u lihet vetë grave. Për qëllim të kësaj analize, ne kemi intervistuar gra në poste politike nga gjitha partitë kryesore, të cilat kanë treguar për sfidat më kryesore që kanë hasur në jetën politike deri në marrjen e posteve politike.

Në fund fare, kjo analizë synon të avancojë politikat e përfaqësimit gjinor në poste emëruese të nivelit qendror dhe lokal, andaj e njëjtë jep propozime konkrete që do të siguronin një përfaqësim gjinor më të mirë.

Pse gratë në politikë?

Popullata e Kosovës ka numër pothuajse të barabartë mes dy gjinive, pasaj femërore dhe mashkulllore¹. Andaj, do të ishte e natyrshme që një demokraci përfaqësuese të prodhonte institucionet me strukturë gjinore të përafërt. Mirëpo në realitet kjo rrallë ndodh në ndonjë vend të botës. Madje edhe në vendet skandinave, ku përfaqësimi gjinor në institucionet publike është shembullor ju është dashur kohë dhe vëmendje e gjatë që të arrihen këto rezultate që ka sot. Edhe qytetet evropiane me demokraci të zhvilluar dhe shoqëri të emancipuar që udhëhiqen nga një grua si Parisi, Roma, Madridi, Barcelona, Sofja e Praga², por edhe shtetet si Gjermania e Britania e Madhe kanë kaluar sfida dhe kanë bërë shumë përpjekje për të arritur një atmosferë barazie mes dy gjinive.

Edhe pse është jorealistë të pritet që shpejt do të arrihet një bilanc gjinor i plotë në institucionet politikbërëse, gjendja aktuale, e cila është tepër dekurajuese tregon që kërkohet një vëmendje e veçantë për të arritur së paku kuotën minimale gjinore. Një gjë inkurajuese për të ardhmen e grave në politikë është se anketa e Demokraci Plus tregon se 89,3% e popullatës i shohin gratë me më pak prirje se burrat për korruption³. Kur merr parasysh që e njëjta anketë tregon që 60,6% e popullatës elementin që më së shumti vlerësojnë në një qeverisje është qeverisja pa korruption, kjo tregon se gratë në Kosovë kanë mundësi të jenë të suksesshme në Kosovë nëse do u jepej rasti.

Përtej përfaqësimit gjinor, përfshirja e grave në politikë është e nevojshme për politikat publike dhe për qeverisjen e vendit. Gratë në politikë u japid vëmendje më të madhe politikave që kultivojnë familje më të shëndosha, politikave sociale dhe arritjes së konsensusit politik.

Mirëpo, për të adresuar këtë gjendje së pari duhet të pranohet se ekziston një nevojë që lind nga një problem. Por nëse dëgjon shumë politikanë, madje edhe shumë qytetarë, nuk e kanë përshtypjen se Kosova sfidohet nga përfaqësimi i ulët gjinor në pozita politike vendimmarrëse. Arsyaja për këtë përshtypje është sepse Kosova ka kuotë gjinore prej 30% në institucionin ligjvënës në nivel qendror, Kuvendin e Kosovës, dhe nivelin lokal, kuvendin komunal. Mirëpo, përderisa kjo është e vërtetë dhe është një progres në përfaqësim gjinor, nga ana tjetër pozitat emëruese në degën ekzekutive, aty ku vendimmarrja dhe pushteti në Kosovë është më i madh, përfaqësimi i gruas është mjaftë i kufizuar (kjo vërehet lehtë me shfletimin e këtij publikimi). Pa kuotë gjinore, shumë lehtë edhe degët ekzekutive do t'i kishim me nivel të ulët të përfaqësimit gjinor, si në ministri, ashtu edhe në komuna.

¹ Statistikat zyrtare tregojnë që struktura gjinore e popullësisë së Kosovës është 50.3% meshkuj dhe 49.7% femra.

² iNews. Meet the new female mayors of Europe's major cities (20 qershor, 2016) <https://goo.gl/7hWZWt> Shikuar më: 15 nëntor, 2018.

³ Democracy Plus. Anketë e realizuar me qytetarë në dhjetor të vitit 2018.

Është e vërtetë se përfaqësimi gjinor në pozita emëruese në degë ekzekutive vështirësohet nga koalicionet qeverisëse me shumë parti, kjo pasi nëse një parti emëron vetëm tre ose katër persona në atë koalicion, gjasat janë që të janë meshkuj. Prandaj, është mëse e nevojshme t'ju jepet mundësia grave në politikë, synim të cilin e ka edhe kjo analizë me gjetjet dhe rekomandimet e shtjelluara.


Poste të Emëruara

- Qeveria e Kosovës

Për të depërtuar në politikë, gratë kanë sfida të shumta, të cilat do të shtjellohen më poshtë. Kuota gjinore prej 30% në institucione ligjvënëse kontribuon për t'i tejkaluar këto sfida për një kohë. Mirëpo, në institucione politike ekzekutive që shkojnë me emërim të subjektit politik dhe që janë poste të rëndësishme vendimmarrëse dhe nga më të pushtetshmet, nuk ka pothuajse fare përfaqësim gjinor. Marrë parasysh këtë, ka mjaft poste politike për të cilat udhëheqësi emërohet nga subjekti politik që është fitues apo është pjesë e koalicionit fitues. Andaj, këtu qëndron edhe mundësia për t'ju dhënë rastin grave përfaqësim në politikë dhe shërbim publik, në degë vendimmarrëse, duke marrë parasysh sfidat shoqërore, familjare dhe ekonomike me të cilat përballen çdo ditë në parti dhe në shoqëri.


Në nivel qendror, në degën ekzekutive të qeverisë, janë tri poste udhëheqëse për të cilat përzgjedha varet plotësisht nga partia dhe strukturat udhëheqëse të partisë: postet e zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave. Madje edhe në degën legjislative, në Kuvend të Kosovës, posti i Kryetarit të Kuvendit i takon partisë që ka marrë më së shumti vota në zgjedhje. Në po të njëjtin institucion, postet udhëheqëse të grüpuit parlamentar dhe përfaqësuesi i grüpuit parlamentar në Kryesinë e Kuvendit janë poste emëruese.

Emërimet në Poste Qeveritare




Ndërsa në nivel lokal, poste emëruese janë posti i nënkyretarit të komunës dhe drejtorët komunal, ndërsa në kuvende komunale posti i kryesuesit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Kuvendit. Madje drejtorët komunal udhëheqin dikastere komunale mjaft të rëndësishme nga arsim, kultura dhe shëndetësia, e deri tek zhvillimi ekonomik lokal, financat dhe shërbimet publike. Këto poste para zgjedhjeve të 2007-së kanë qenë poste të shërbimit civil, por me ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së drejtëpërdrejtë për kryetarë të komunës, të njëjtat u shndërruan në poste politike për të cilat vendos subjekti/tet që fitojnë zgjedhjet lokale.

Përfaqësimi Gjinor në Qeverinë Haradinaj



Të dhënat tregojnë që edhe pse ka mjaft mundësi për emërim në këto pozita udhëheqëse për të cilat subjektet politike vendosin, përfaqësimi i grave është tejet i ulët. Madje, edhe kur numri i posteve në këto nivele është rritur, përfaqësimi i grave ka qenë i ulët. Këtë fakt e dëshmojnë dy mandatet e fundit të Qeverisë, ku shohim se asnjë grua nuk është emëruar në poste të zëvendëskryeministrave.

Përfaqësimi Gjinor në Qeverinë Mustafa



Në mandatin 2014-2017 kanë qenë tre zëvendëskryeministra dhe të gjithë kanë qenë meshkuj. Në mandatin aktual, edhe pse numri i zëvendës-kryeministrave është rritur në pesë, prapë asnjë grua nuk është emëruar. Ndërsa dihet që posti i kryeministrit nuk është mbajtur

asnijëherë nga një grua në Kosovë dhe madje as që ka patur kandidime për kryeministër nga partitë. Kjo edhe për faktin që të gjitha partitë kryesore në vend udhëhiqen nga meshkujt.

Në mandate të mëhershme pozita të zëvendës kryeministrave kanë mbajtur gra, si Mimoza Kusari-Lila dhe Edita Tahiri, mirëpo nuk del të jetë e njëjtë në dy mandatet e fundit edhe pse numri i këtij lloj posti është rritur.

Por më rëndësi janë edhe postet e ministrave pasi udhëheqin dikastere të caktuar me kompetenca ekzekutive. Këtu ndoshta mbetet pjesa më problematike e përfaqësimit të gruas në politikë. Edhe pse në fushatë zgjedhore të vitit 2017, udhëheqësi i koalicionit parazgjedhor i cili edhe fitoi më së shumti vota kishte premtuar se qeveria e ardhshme do të ketë përfaqësim të grave me 50%⁴, premtim i cili nuk është mbajtur.

*"Gruaja do ta bëjë
50% të qeverisjes
së ardhshme të
Kosovës"*

- **Kadri Veseli**
(28 maj, 2017)

Pas formimit të Qeverisë, vetëm dy gra ishin emëruar në poste ministrore, për dallim nga gjinia tjetër, ku kanë zënë 17 poste të tilla, numër ky duke mos i përfshirë pesë postet e zëvendëskryeministrave dhe kryeministrit që e potencuam më herët që udhëhiqen nga meshkuj. Madje edhe partia që udhëheq më së shumti poste ministre, partia e z. Kadri Veseli, PDK-ja, kishte emëruar vetëm një grua në post ministror.

Vlen të theksohet se pas një viti, Qeveria mbeti me vetëm një grua me post ministror dhe atë në Ministrinë për Integrim Evropian, ministri e cila ka më shumë rol koordinues sesa ekzekutiv.

Struktura gjinore e këtyre partive edhe mund ta arsyetoj mosemërimin e grave në poste ministre, mirëpo një arsyetim i tillë nuk vlen për emërimet në pozitat e zëvendësministrave. Edhe pse në qeverinë aktuale flitet për më shumë pozita të tilla, nga 76 zëvendës ministra sa kemi arritur t'i identifikojmë, vetëm gjashtë janë gra, ndërkaq të tjerët nuk kemi arritur t'i identifikojmë, për shkak të mostrasparencës në emërimë. Madje as në qeverinë e mëhershme (2014-2017) e cila kishte 47 zëvendës ministra të deklaruar⁵, përfaqësimi i grave nuk ishte as për së afërm me numrin e ministrave meshkuj. Nga 28 zëvendësministrat e parë të cilëve ju ishte publikuar emri, vetëm katër ishin gra⁶.

⁴ Gazeta Express. "Veseli: Në qeverinë e ardhshme, 50 për qind gra" (28 maj, 2017). <https://goo.gl/SFwQJm>. Shikuar më 5 nëntor, 2018.

⁵ Lajmi.net. "Sa Zëvendës-Ministra Kishte Qeveria Mustafa" (2015, 28 Korrik). <https://goo.gl/82Ntcg>. Shikuar më 19 nëntor, 2018.

⁶ Bota Sot. Kompletohet Qeveria Mustafa: Emërohen 28 Zëvëndës-ministra (2017, 8 Dhjetor). <https://goo.gl/xyzurk>. Shikuar më 18 nëntor, 2018.

Pra shihet qartë se edhe në poste ku ka mjaft mundësi për emërime nga subjektet politike, aspekti gjinor anashkalohet. Shumë zyrtarë politik mund të pyesin se pse qenka kaq e rëndësishme që të emërohen gra në poste të kabinetit qeveritar? Përgjigja për këtë pyetje mund të jepet lehtë nëse analizohen më afér efektet e përfaqësimit të gruas si ministre, zëvendës kryeministre, apo si zëvendësministre. Udhëheqës të këtyre posteve marrin vëmendje mediale, marrin vendime që tërheqin vëmendjen e njerëzve dhe i sfidojnë personat që të përgatiten politikisht. Kjo përvojë në poste ministrore i bënë gratë më konkurruese në zgjedhje. Mjafton të merrni cilëndo grua që ka shërbyer si ministre në Kosovë dhe ta vëreni popullaritetin që e ka fituar qoftë në popull apo konkretisht te votuesit.

- Qeveri Komunale

Mund të duket e vështirë për t'u besuar, por niveli lokal në përgjithësi, nuk qëndron fare më mirë se niveli qendror sa i përket emërimit të grave në poste politike udhëheqëse. Mirëpo, një zhvillim pozitiv në këtë drejtim është vullneti i disa komunave individuale për t'i dhënë rëndësi emërimit të grave në pozita udhëheqëse.

Shkalla e kandidimit të grave për postin e të parit të komunës qëndron më së dobëti. Nga 208 persona sa kishin kandiduar subjektet politike në zgjedhjet lokale të vitit 2017, vetëm tetë ishin femra. Pra vetëm 4% të garuesve kanë qenë femra. Kandidimi për kryetarë të komunës varet nga strukturat lokale të partisë dhe garës së brendshme. Megjithatë, përkrahja për gra brenda partive shihet qartë se mungon.

Duke pasur parasysh faktin që 2,398 gra kanë garuar për kuvend komunal në 38 komuna, atëherë shihet qartë se ka pasur mjaft gra që kanë kërkuar poste publike⁷. Zgjedhja e kryetarit të komunës pastaj sigurisht që varet nga votuesit. Për shumë faktorë që shkojnë përtjer çështjeve gjinore, në këto zgjedhje, në asnjë nga ato tetë komuna ku ka pasur garuese femra, nuk janë zgjedhur nga votuesit. Në fakt, në historinë e zgjedhjeve demokratike të Kosovës, vetëm një grua është zgjedhur kryetare e komunës⁸.




⁷ EU Observation Mission. "Preliminary Statement: Two faces of Kosovo municipal elections" (24 tetor, 2017). <https://goo.gl/DGYaoS> Shikuar më: 12 nëntor, 2018.

⁸ Në Komunën e Gjakovës në vitin 2013 ishte zgjedhur Mimoza Kusari-Lila, dhe mbetet e vetmja grua deri më tanë e zgjedhur në postin e kryetarit të komunës.

Mirëpo, poste tjera udhëheqëse e të rëndësishme në komunë varen nga subjektet politike, të cilat mund të japid shembull të mirë edhe për votuesit që të nxjerrin gra politikane. Por kjo shansë nuk u është dhënë grave nga vetë partitë të cilave u takojnë. Në 38 komunat e Kosovës, kemi vetëm dy nënkyetare të komunës, në komunat e Suharekës dhe Mamushës, ndërsa vetëm pesë kryesuese të kuvendit, në komunat e Ferizajt, Gjilanit, Skenderajt, Shtimes dhe Fushë Kosovës.


Poste Udhëheqëse në Komunë Mandati 2017 - 2021



Mundësitet më të mëdha për emërim të grave në pozita udhëheqëse në nivel lokal janë drejtoritë komunale. Këto drejtori që nga viti 2007 janë poste politike dhe emërimi i personave në këto poste bëhet nga subjektet politike me të cilat ka koalicion kryetari i komunës. Po ashtu, numri i këtyre drejtorive nuk është i rregulluar me ligj dhe është në diskrecion të kryetarit të komunës. Numri i drejtorive dallon nga komuna në komunë, ku për shembull me gjashtë drejtori funksionon Komuna e Mamushës, përderisa Komuna e Prishtinës me 16 të tillë. Pra ka mjaft mundësi që të emërohen gra profesioniste, por kjo mundësi nuk po ju jepet të njëjtave.


Mirëpo, në mandatin 2009-2013, nga 303 drejtori komunale që i kemi identifikuar në 31 komuna, vetëm 22 drejtori janë udhëhequr nga gra, pra vetëm 7%. Asnjë grua nuk ka udhëhequr drejtori në 17 komuna, ndërsa në 11 komuna vetëm një drejtori ka qenë e udhëhequr nga një grua. Komuna e Graçanicës, ka qenë e vëtmja që ka pasur një balance gjinor në drejtoritë komunale, tri gra dhe katër meshkuj.

Mandati 2009 - 2013
Drejtoritë Komunale dhe Përfaqësimi Gjinor




Në mandatin aktual, emërimi i grave në drejtori komunal është përmirësuar pak, mirëpo prapë qëndron në shkallë nën 19%-shit dhe këtë për shkak se 2 komuna kanë emëruar numër të njëjtë të grave me meshkuj në drejtori komunal.

Mandati 2017 - 2021
Drejtoritë Komunale dhe Përfaqësimi Gjinor



Nga 364 drejtori komunale sa janë identifikuar në 37 komuna, 75 drejtori udhëhiqen nga gra. Shembull të mirë në këtë mandat kanë dhënë Komuna e Kamenicës, Drenasit dhe Kllokotit që kanë balancë të plotë gjinor në poste udhëheqëse të drejtorive. Këto dy komuna tregojnë që nëse ka vullnet, përfaqësimi gjinor mund të sigurohet madje edhe në nivel 50% gra dhe 50% burra.

Drejtoritë Komunale Komuna e Prizrenit



Drejtoritë Komunale Komuna e Ferizajt



Drejtoritë Komunale Komuna e Gjakovës



Poste të Zgjedhura

- Nivel Qendoror

Në Kuvend të Kosovës ekziston kuota gjinore prej 30% dhe është i vetmi institucion qendoror anëtarët e të cilët zgjidhen me votë të drejtpërdrejtë. Një prej mënyrave për të ilustruar se jo secila grua e zgjedhur ka arritur në pozitat e tyre përmes kuotës gjinore, është edhe identifikimi i 10 deputetëve më të votuar nga partitë politike. Të dhënat nuk janë të kënaqshme, megjithatë tregon se mbështetja për angazhimin e grave në politikë ekziston, ani pse në masë të vogël. Mbështetje jo e duhur vërehet më së shumti tek deputetët nga radhët e koalicionit PAN dhe LAA – nga 10 deputetët më të votuar, vetëm dy prej tre kanë qenë gra. Pak më mirë qëndrojnë LVV dhe LS. Tek LVV shohim se nga 10 deputetët më të votuar, tre prej tyre kanë qenë gra, kurse tek LS nga 9 deputetë, 4 janë gra.

Mandati 2017 - 2021
10 Kandidatët më të Votuar




Nëse analizohet Kuvendi i Kosovës si tërësi, shohim një gjendje e cila nuk përkon me paragjykimet e shoqërisë. Kjo pasi, qoftë nga kundërfushata të shumta, apo edhe nga mungesa e vetëdijes, në shoqëri ekziston bindja se shumica dërrmuese e deputeteve kanë arritur vetëm përmes kuotës gjinore, dhe se po të mos ishte kjo pjesëmarrja e grave do të ishte edhe më e ulët. Nga ana tjetër për nivelin qendoror nuk qëndron tërësisht kjo mendësi, meqë përgjatë tre mandateve të fundit qeverisëse, 45% të grave deputete kanë qenë të zgjedhura puro nga vota e qytetarëve dhe jo nga kuota⁹. Në fakt, përgjatë viteve vërehet të ketë përmirësimë në këtë aspekt. Përderisa në zgjedhjet e vitit 2010 kemi numrin më të lartë të deputeteve të cilat janë zgjedhur me ndihmën e kuotës, viti 2014

⁹ National Democratic Institute (NDI). Kosova: Tejkalimi i pengesave për pjesëmarrjen politike të grave. Shkurt, 2015. <https://goo.gl/ZFTx5M>

tregon përmirësim të dukshëm, me 51% të deputeteve të zgjedhura me votën e qytetarëve – pa ndihmën e kuotës. Kjo nuk nënkupton që këto të dhëna janë të kënaqshme, megjithatë fakti se ekziston një trend i rritjes së besimit të qytetarëve ndaj kandidateve gra është inkurajues.


Gratë e Zgjedhura në Kuvendin e Kosovës



- Nivel Lokal

Gjendja nuk është e njëjtë edhe për nivelin lokal. Të dhënrat nga zgjedhjet lokale janë më shqetësuese. Duke nisur që nga kandidimi në zgjedhjet lokale të 2017-së, nga 6,887 kandidatë në përgjithësi, vetëm 34% prej tyre ishin gra. Ndërsa pas zgjedhjeve, shohim se nëpër kuvende të komunave kuota gjinore ka luajtur rol tejet imperativ. Nga gjitha anëtaret e kuvendeve komunale, 65% kanë arritur aty falë kuotës gjinore¹⁰.

Gratë në Kuvendet Komunale Zgjedhjet Lokale 2017



¹⁰ Akademia e Grave për Lidership (AGL). (Pa) Barazia Gjinore në vendimarrje në nivel lokal. Maj 2018. <https://goo.gl/bAsAzt>

Këto të dhëna më shqetësuese i bën fakti që edhe partitë më të mëdha në Kosovë ballafaqohen me të njëjtin problem – kandidatet e tyre zgjedhen përmes kuotës gjinore dhe jo plotësisht nga numri më i madh i votave. Kjo lë të nënkuftohet se mbështetja ndaj kandidateve gra brenda partisë vazhdon të jetë e ulët, edhe pse këto parti kanë shumë më shumë ndikim tek qytetarët dhe resurse financiare, sesa partitë më të vogla.

Ajo çfarë vërehet nga të dhënat e rezultateve të zgjedhjeve është se sa më i lartë numri i anëtarëve të një partie në kuvende komunale, aq më e lartë përqindja e të zgjedhurve me kuotë. Nëse analizojmë tri partitë me më së shumti gra anëtare në, LDK, PDK dhe VV, shohim se përqindja e grave të zgjedhura me ndihmën e kuotës gjinore është në një shkallë shumë të lartë. Pak më mirë qëndron LDK-ja, ku pak mbi gjysma e kandidateve gra (565) janë zgjedhur falë kësaj kuote. Ndërsa PDK dhe LVV qëndrojnë relativisht njëjtë, me 67% të anëtarëve të zgjedhura me ndihmën e kuotës gjinore.

2,398 gra kanë garuar për kuvend komunal në zgjedhjet lokale të vitit 2017, nga 6,887 kandidatë në përgjithësi.

Niveli lokal do të duhej të kishte pasqyrë tjetër të të dhënave, marrë parasysh faktin se kandidatët janë shumë më afër me qytetarin krahasuar me deputetët. Pra, do të duhej të ishte më i lehtë fitimi i besimit të qytetarëve, rrjedhimisht duke pasur më shumë anëtare të zgjedhura vetëm nga vota e qytetarëve, dhe jo nga kuota. Në anën tjetër, mungesën e kandidimit të grave për kuvende komunale nuk mund ta arsyetojmë me hezitim të tyre, meqë angazhimet dhe kërkesat e punës në këtë institucion janë shumë më të ulëta krahasuar me ato të Parlamentit të Kosovës. Andaj, ajo çfarë mbetet të kuftohet është se faji më i madh për mosangazhimin e grave në skenën politike ju takon partive politike duke mos i mbështetur dhe duke mos ua dhënë besimin e duhur.


Poste Partiake

- Nivel Qendoror

Në aspektin organizativ, partitë politike përveç liderit të tyre – kryesinë, kanë Këshillin e Përgjithshëm dhe degët e partisë. Funksionaliteti i partisë varet në funksionimin dhe bashkëpunimin e këtyre strukturave me njëra tjetër. Përderisa kryesia është përgjegjëse për orientimin e partisë, kjo kryesi zgjedhet nga Këshilli i Përgjithshëm, ndërsa në këtë të fundit marrin pjesë anëtarë të cilët janë ngritur nga pozitat e tyre në degët e partisë. Pra, strukturat e partisë janë hapa të cilët duhet kaluar për t'i arritur pozita kyçë në parti. Mirëpo, sa gra në fakt kalojnë nëpër gjithë këta hapa për të arritur deri në pozitat kyçë të dëshiruara?

Përceptimi për Kosovën është se gratë jo vetëm që nuk përfaqësohen mjaftueshëm në institucione publike, por atyre ju mungon përkrahja edhe përbrenda partive të tyre politike. Për arsy që mund të jenë të ndryshme, numri i grave në pozita kyçë në parti është shumë i vogël, e sidomos kur kahasohet me numrin e burrave në këto pozita.


Këshillat e Përgjithshme të Partive Politike



Në Këshille të Përgjithshme, sipas të dhënave të publikuara nga partitë politike, gratë përbëjnë vetëm 22.8% të anëtarëve, që në numër i bie të jetë vetëm 96 anëtarë gra. Shqetësuese është fakti që nga tre partitë politike, PDK, VV dhe AAK, të dhënat e të cilave ishin të qasshme, partitë me më së shumti anëtarë në Këshill të Përgjithshëm kanë më së paku anëtarë gra. Përjashtim bën VV, e cila më së shumti i afrohet përfaqësimi të barabartë të grave dhe burrave në këtë strukturë, me 33 anëtarë gra, apo 30% në total. Ndërsa më së keqi qëndron PDK-ja, e cila njëkohësisht ka Këshillin me numrin më të madh të anëtarëve (184) me përfaqësimin më të dobët të grave, me vetëm 38 anëtarë, apo 20% në total.


Kuptohet se këto shifra ndikojnë po ashtu në shifrat e përfaqësimit të grave edhe në instanca më të larta në parti. Mund të supozojmë se këto këshille, ku mungon përfaqësimi i grave, do të zgjedhin kryesi me po të njëjtin problem dhe strukturë gjinore. Në fakt, nëse analizojmë partitë politike në Kosovë shohim se kjo në fakt përkon me realitetin. AAK si partia me kryesinë me më së shumti anëtarë, ka vetëm 12 gra, nga 60 gjithsej. Ngjashëm qëndron edhe PDK-ja, e cila radhitet pas AAK-së për nga numri i anëtarëve të kryesisë, e cila nga 50 anëtarë ka vetëm 13 anëtarë apo 26%.

Këshilli i Përgjithshëm (Perbërja Gjinore)



LDK dallon dukshëm nga partitë e përmendura për nga numri total i anëtarëve të kryesisë, mirëpo ngjashëm si partitë paraprake, nuk i afrohet përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave në këtë aspekt. 50%-it të kërkuar më së shumti i afrohen VV-ja dhe PSD-ja, me 37.5% dhe 39.1%, gjegjësisht me numër të anëtarëve gra në kryesi. Për këto parti, të dhënat e të cilave janë të hapura për publikun vërehet se gjendja është e ngjashme si në Këshill të Përgjithshëm, ashtu edhe në kryesi. Përfaqësimi i ulët i grave në pozita kyçë të partive është alarmant, dhe kjo mund të jetë edhe një nga faktorët se pse ky mospërfaqësim i grave pasqyrohet edhe në institucione.

Kryesia e Partisë (Perbërja Gjinore)




- Nivel Lokal

Një fakt i njojur për skenën e politikës është se shansat janë tejet të vogla që një politikan të marrë kandidaturën për kryetar komune, nëse paraprakisht nuk ka qenë kryetar i Degës në atë komunë. Ngritja në parti dhe në politikë pra fillon qysh nga Dega e Partisë. Mirëpo, sa u jepet hapësirë grave të marrin kreun në këto degë? Nga tre partitë politike të cilat i kemi analizuar, LDK, VV dhe PDK, të cilat gjithsej kanë 94 degë përgjatë komunave të Kosovës, vetëm 8 prej tyre kryesohejnë nga gra. LDK ka 37 degë në Kosovë, dhe nuk ka asnje degë e cila udhëhiqet nga një grua. Pas saj radhitet PDK-ja, e cila nga 31 degët e saj, vetëm dy degë iu janë besuar të udhëhiqen nga një grua.

Kurse VV shfaqet pak më mirë në krahasim me këto dy parti, mirëpo të dhënat mbeten prapë alarmante. Nga gjithsej 26 degë të saj, vetëm gjashtë prej tyre udhëhiqen nga gratë. Arsyet për këtë mungesë kaq të madhe të përfaqësimit të grave në politikë mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm, mirëpo fakti mbetet se gratë po vazhdojnë të janë të nën-përfaqësuara në të gjitha strukturat e partisë – në të gjitha partitë.

Degët e Partive Politike
(për të cilat kemi gjetur të dhëna)



Sfidat e Përfaqësimi të Gruas

Të dhënët e gjetura tregojnë që pjesëmarrja e grave në pozita vendimmarrëse brenda partisë është tejet e ulët. Kjo ndikon jo vetëm në politikat e partive politike, por edhe në botën politike jashtë partive. Ky fenomen tash e sa kohë mundohet të kamuflohet me pretekstin se gratë vet nuk janë të interesuara të marrin pozita kyçë në parti, apo edhe kandidaturën nga partia. Megjithatë, nga intervistat e bëra me gra të angazhuara në skenën politike në Kosovë, lihet të kuptohet se në fakt për gratë, shanset janë kundër tyre qysh në hapat e parë. Kandidimi për zgjedhje, si një ndër hapat më të thjeshtë për të arritur në pozita udhëheqëse, kërkon kohë, energji dhe mbi të gjitha financa.

Sipas të intervistuarave, kur është fjala për kandidategra, këto tre faktorë janë të komprometuar qysh në fillim të procesit. Standardet e dysfishta, struktura politike të dominuara nga burrat, si dhe ndarja jo e drejtë e financave brenda partisë janë vetëm disa nga arsyet se pse mbërritja në pozita udhëheqëse është më sfiduese për gratë sesa për burrat.

- Kandidimi për Zgjedhje

Përtej gjendjes së ilustruar për gjendjen politike të grave brenda partive politike, sfidë e vazhdueshme është kandidimi në zgjedhje, qofshin lokale apo qendrore. Nga intervistat e zhvilluara me deputete dhe anëtarë të kuvendeve komunale të partive të ndryshme politike në Kosovë, doli se vështirësitet me kandidim fillojnë me mosbesimin e plotë të partisë ndaj grave, e vazhdon pastaj edhe me fushatën zgjedhore e deri në zgjedhje.


Gratë vazhdojnë të janë targeti i mundësive jo të barabarta përbrenda partisë. Numri i grave të angazhuara në parti politike të cilave u besohen emërimë politike në institucione qeverisëse vazhdon të jetë në nivel shumë të ulët. Pozita si shefe të grupit parlamentar, përfaqësuese në kryesi të Kuvendit, kryesuese të kuvendit komunal, nënkyetare të komunës janë disa nga postet udhëheqëse ku rrallëherë shohim t'i besohet një gruaje.

Këto emërimë janë puro politike, dhe vendoset nga partia, andaj për këtë fajësitet partia e jo elektorati. Këtë e thotë edhe deputetja Lirije Kajtazi e cila shprehet se "meqenëse edhe asambletë edhe qeveria lokale dhe qendrore derivon nga partitë politike, problemi është tek partitë politike, aty nuk janë të përfaqësuara si duhet në mënyrë që ta kenë atë fuqinë që edhe të zgjedhen¹¹."

Përveç qasjes për gratë kandidate për kryetare komune, edhe vetë qytetarët thuajse kanë të njëjtën qasje. Qytetarët e pyetur për atë se cilën gjini do ta votonin më shumë për kryetarë komune, 52.6%

¹¹ Intervistë personale me Lirije Kajtazi (LDK). Deputete në Kuvend të Kosovës. 13.11.2018.

deklaruan për burrat, ndërsa pjesa tjetër për gratë. Përqindje kjo që në pamje të parë nuk duket e lartë, por dallon kur ndalemi tek ajo se kë do ta votonin burrat dhe kë gratë. Siç edhe mund të shihet në grafikën e më poshtme, burrat do të votonin për burrat dhe gratë për gratë. Respektivisht 70.7% nga burrat e anketuar thanë se do të votonin një burrë për kryetar, ndërsa 65.9% e grave thanë se do të votonin për gratë.



Përveç aspektit të përgjithshëm se kë do të votonin, shifra relativisht të njëjtë hasim edhe tek aspektet tjera demografike. Kur jemi te mosha, rezultatet e anketës sonë treguan që grup-moshat 25-34 dhe 45-54 vjeç në një përqindje të vogël 50% dhe 52.7% deklaruan që do të votonin gratë për kryetare sesa burrat. Ndërsa kur jemi tek edukimi, ata me disa vite shkollë të mesme dhe me fakultet të kryer me 54.3% dhe 54.4% preferuan gratë në krye të komunës. Ekonomia dhe të punësuarit dolën të jenë një faktor që përcakton edhe bindjet e tyre për të votuar. Të papunë (50.8%), ata pa të ardhura personale (59.4%) dhe familjare (52.9%) dhe amviset (65.6%) deklaruan se do të votonin gratë më shumë se burrat. Ndërsa në bazë të të ardhurave personale, të atyre që janë të punësuar, vetëm ata me pagën nga 751-900 euro, me 57,1% thanë se do të votonin gratë më shumë sesa burrat¹².

- Financimi i Fushatës

Kandidimi për zgjedhje kërkon marketing të mirë, promovim dhe vëmendje mediatike. Kjo ndryshtë mund të përkufizohet edhe vetëm me fushatë zgjedhore. Në mënyrë që fushata të jetë e suksesshme dhe programi i kandidatit të arrijë deri tek publiku, nevojitet një shumë e konsiderueshme e parave. Këtu qëndron edhe njëri nga problemet e radhës brenda partive politike. Gratë e intervistuara tregojnë se shpërndarja e financave brenda partisë bëhet në mënyrë jo të drejtë, dhe se gjatë fushatave të tyre zgjedhore nuk kanë pasur mbështetje të mjaftueshme nga partia, apo në rastin e LVV, mbështetja ka qenë simbolike.

¹² Democracy Plus. Anketë e realizuar me qytetarë në dhjetor të vitit 2018.

Anëtarja e Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e PSD-së, Visare Gorani, e thotë si diçka të pakontestueshme faktin se ndarja e buxhetit nuk bëhet në mënyrë të drejtë mes burrave dhe grave. Ajo këtë e sqaron me një teori të thjeshtë të ndarjes së buxhetit brenda partisë: “[Ajo] *ndarja e këtij kulaçi buxhetor kushtimisht bëhet mes burrave dhe ata që janë në fillim të listës apo tek favoritet, ndërsa gratë nuk llogariten tek favoritet pasi e dinë që për shkak të kuotave gratë edhe ashtu çdo e treta që është në listë do të hyjë¹³.*” Gorani vazhdon të theksojë se dedikimi i të hollave për fushata zgjedhore të kandidatëve gra jo vetëm që vlerësohet si investim i kotë, por edhe humbje e kohës. Pra, ndihma financiare ndaj grave jo vetëm që nuk shihet si diçka e pranueshme, por ajo vlerësohet edhe si pengesë për suksesin e kandidatëve tjerë brenda partisë.

Kjo qasje ndaj grave është shqetësuese, përfaktin se lë të kuptohet që trajtimi jo i barabartë i grave fillon nga përshtypjet apo paragjykimet e shoqërisë, e përforcohet edhe përbrenda partisë.

- Struktura të Dominuar nga Burrat

Përfaqësimi gjinor vështirë se merret parasysh në proceset e vendimmarrjes, kur në këto procese pjesa më e madhe e akterëve relevantë janë burra. Mungesa e balancit gjinor në politikë nuk mund të rregullohet pa përfshirjen e grave në procese vendimmarrëse, dhe marrja e pozitave me më shumë kompetenca ekzekutive si në nivel lokal, ashtu edhe në atë qendror. Nëse shikojmë nga ana hierarkike, sa më e lartë të jetë pozita dhe sa më të larta të jenë kompetencat vendimmarrëse, aq më i ulët është numri i grave të emëruara.

Për të zbutur këtë diskrepancë mes burrave dhe grave shpesh propozohen dhe miratohen edhe politika stimuluese, siç është rasti me kuotën gjinore në institucione publike. Megjithatë, për shumë raste, kjo politikë vetëm sa vazhdon të dëmtojë gratë, pasi në shumicën e rasteve kjo përdoret nga burrat si kundërfushatë për kandidatet gra, edhe pse janë bashkëpartiak. Besa Gaxherri shprehet se “Burrat kuotën po e përdorin si antifushatë, thonë mos e votoni këtë grua pasi ajo shkon me kuotë gjithsesi, jo që nuk e meriton, e meriton por nuk keni nevojë ta votoni pasi ajo shkon me kuotë, ju lutem na votoni¹⁴.”

Mirëpo kjo nuk është e vëtmja pikëpamje në lidhje me kuotën gjinore. Deputetja Shqipe Pantina nga radhët e PSD-së e mirëpret këtë politikë duke thënë se “Prapë gratë e kanë arsyetuar më shumë mbështetjen që e kanë marrë ose vendin që e kanë zënë më shumë sesa burrat. Edhe nëse e kthen në përqindje, prapë gratë dalin më mirë në angazhim sesa burrat, por kuota ka ndihmuar, pasi është thyer ajo, nuk ka qenë tabu, por ka qenë e vështirë të mendohet, e kanë pasur pothuajse të pamundur¹⁵ .”

¹³ Intervistë personale me Visare Gorani (PSD). Anëtar e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 14.11.2018.

¹⁴ Intervistë personale me Besa Gaxherri (LDK). Deputete në Kuvend të Kosovës. 13.11.2018.

¹⁵ Intervistë personale me Shqipe Pantina (PSD). Deputete në Kuvend të Kosovës. 08.11.2018.

Në rastin e emërimeve politike, liderët arsyetohen se vendimet i marrin duke pasur parasysh interesin e partisë, si çështje primare. Për këta liderë interesat e partisë arrihen më së miri përmes emërimit të burrave në këto poste, meqë numri i grave vazhdon të jetë tejet i ulët. Kjo vërehet shumë në nivelin lokal, si me rastin e Komunës së Prishtinës. Anëtarja e Kuvendit të Prishtinës nga radhët e LVV, Leonora Bajrami shprehet se "Nëse nisemi prej Komunës së Prishtinës, kuptohet që kryetari i komunës ka bërë koalicion me shumë parti dhe se cilës parti duhet që t'i jepet një post që është shumë i rëndësishëm, nuk ofrojnë gra por ofrojnë nga një burrë dhe për t'i shuar ato etjet e tyre për pushtet." Ngjashëm shprehet edhe anëtarja nga radhët e AAK-së e cila shprehet se më e vështira të pranohet është fakti se në shoqëri "Pikë së pari të shohin si femër pastaj si profesionaliste¹⁷."

- Përshtypjet Shoqërore

Zanafilla e gjithë këtyre sfidave në fund del të jetë shoqëria si tërësi – ky po që është një kundërshtar i paevitueshëm. Shoqëria veçse i ka përshtypjet dhe pritshmëritë e saj ndaj grave në politikë, dhe këta liderë politikë të gjithë janë pjesë e po asaj shoqërie. Deri tash, ajo që është vërejtur është se në vend se këto paragjykime të zbuten apo përmirësohen, ato vetëm legjitimohen me ardhjen e burrave në pushtet – qoftë brenda partisë, në qeverisje lokale apo edhe në atë qendrore. Ky problem thellohet edhe më shumë kur marrim parasysh faktin se shoqëria jonë tradicionalisht njihet si një shoqëri patriarkale. Sipas Goranit, kjo bën që në procese vendimmarrëse të mos mungojë gjuha seksiste, si dhe qëndrime maskimiliste, që në njëfarë mënyre qysh në fillim i dekurajon gratë nga tentimi për t'u bërë pjesë në këto procese.

Fatkeqësisht, ndikimi i shoqërisë apo botëkuptimeve të krijuara në shoqërinë patriarkale vërehen edhe kur gratë marrin pozita të larta vendimmarrëse. Znj. Fitneta Bejta i hedh dritë realitetit që shpesh e kemi vërejtur në Kosovë se edhe kur një grua të jetë në një pozitë të lartë udhëheqëse, p.sh: ministre, në ekipin e saj rrëth vetit që ajo vet e krijon prapë se prapë dominojnë burrat, kështu duke mos pasur në konsideratë barazinë gjinore. Kjo është vetëm një nga format e shumta se si shoqëria ndikon në politikëbërje dhe në procese vendimmarrëse – si te burrat, ashtu edhe te gratë.


Aspekti gjeografik i asaj se çfarë bindjesh kanë banorët që jetojnë në zonat urbane dhe rurale, paraqet një element që deri në një masë edhe përcakton edhe preferencat për votim. Ndonëse nuk ka diferenca të mëdha dhe të dy zonat si urbanja ashtu edhe ruralja do të preferonin burrat për kryetar komune sesa gratë. Siç mund ta shohim numerikisht dhe grafikisht të paraqitur më poshtë, shohim se 51.3% të banorëve

¹⁶ Intervistë personale me Leonora Shabani Bajraktari (LVV). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 12.11.2018.


¹⁷ Intervistë personale me Fitneta Bejta (AAK). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 14.11.2018.

urban do të preferonin burrat, ndërsa me një përqindje pak më të madhe kemi ata në zonat rurale, që nëse e përkthejmë në përqindje na del 53.9% ¹⁸.

Banorët urban preferojnë ta votojnë për kryetarë komune një...



Banorët rural preferojnë ta votojnë për kryetarë komune një...



- Obligimet Familjare

Nga shoqëria derivojnë mandej edhe obligimet familjare – pritshmëritë që dallojnë në mënyrë drastike për burra dhe gra. Obligimet e shumta familjare, që edhe vet gratë ia ngarkojnë vetës, dalin të jenë pengesa. Në fakt, pengesë nuk del të jetë medoemos performance e tyre, por dyshimi në performancën e tyre nga kolegët përreth. Të pasurit shumë role njëkohësisht, sidomos rolin e nënës si kujdestare për fëmijët e saj, është arsyja pse përgjegjësitë për emërimë politike nuk i konsiderojnë gratë si kandidate potenciale. Ata kanë bindjen se performance e saj politike do të jetë e dobët, por pa pasur fakte për ta mbështetur këtë gjë. Për këtë, znj. Jeta Rafuna nga radhët e LDK-së, thotë se *"Sfida në përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet ka jashtëzakonisht shumë, duke e pasur parasysh se gruaja është njëkohësisht bashkëshorte dhe nënë, pra gjithmonë duhet t'i jepet trefishi më shumë sesa një mashkulli që ka një pozitë udhëheqëse"*¹⁹.

Megjithatë ka raste kur kërkesat e një pozite mund të jenë më sfiduese dhe në rast të ofrimit të këtyre pozitave, gratë detyrohen t'i refuzojnë. *"Nëse marrim Drejtoren e Shërbimeve Publike, e njëjta kërkon gatishmëri 24 orë. Nëse ke vërvshime në mesnatë, ti si drejtoreshë duhet të dalësh, nëse je nënë e një apo më shumë fëmijëve e ke pak problem* ²⁰ shprehet Mimoza Sylejmani nga radhët e PSD-së.

Në anën tjetër deputetja Albulena Balaj nga NISMA për Kosovën, kur flet për këtë, merr vetën e saj si shembull për të ilustruar sfidat e grave në politikë. *"Në zgjedhjet e para të 2014-ës kur Nisma është futur për herë të parë pas tre muajve të themelimit, kam qenë në muajin e katërt të*

¹⁸ Democracy Plus. Vëmendje Angazhimit Qytetarë: Mangësitë dhe Mundësitë.

¹⁹ Intervistë personale me Jeta Rafuna (LDK). Anëtarë e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 09.11.2018.

²⁰ Intervistë personale me Mimoza Sylejmani (PSD). Anëtarë e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 13.11.2018.

pushimit të lehonisë. Pra, e kam pasur vajzën në gji dhe imagjinoni, prej një tubimi elektoral që kemi pasur është dashur të kthehem në shtëpi t’i jap vajzës gji, të shkoj në tubimin tjeter, pastaj të shkoj në shtëpi për të njëjtën procedurë²¹. Sfidat nga përvoja personale të deputetës Balaj nuk mbarojnë këtu. Balaj vazhdon me tregimin e saj: "Kjo është një sfidë, ndërsa në zgjedhjet e 2017-tës, ku pata rastin të bëhem deputete isha në muajin e nëntë të shtatzënisë, imagjinojeni në këtë gjendje isha në fushatë bashkë me burrat, krah për krah me ta, pa i lëshuar rrugën dhe arrita të jem këtu ku jam. Pra sfidat ekzistojnë. Sapo u zgjodha deputete linda vajzën tjeter dhe menjëherë me aktivitetet e kuvendit, të deputetit, politike."

Gjithë këto sfida dhe këto pritshmëri nga gratë, jo vetëm nga shoqëria por edhe nga vet Gratë, ndikojnë në hezitim e tyre për angazhim politik. Fatkeqësisht kjo ndikon në performancën e atyre grave që veçse janë pjesë e skenës politike, pasi atyre ju shtohet edhe një betejë tjeter, të cilën duhet ta luftojnë – stereotipet gjinore. Prandaj edhe vazhdojmë ta kemi gjendjen që kemi, me këto statistika mjaft shqetësuese.

²¹ Intervistë personale me Albulena Balaj (Nisma). Deputete në Kuvend të Kosovës. 22.11.2018.

Zgjidhja për Përfaqësim Gjinor në Poste të Emëruara

- Poste të Emëruara në Kabinet Qeveritar

Ligji për Qeverinë i cili është në hartim, me të drejtë pritet që të rregulloj kabinetin qeveritar, duke përfshirë këtu numrin e ministrive si dhe të zëvendësministrave. Për arsyet e problemeve që ka Kosova me përfaqësim gjinor në pozita vendimmarrëse në nivel të qeverisë dhe sfidave që paraqiten në përfaqësimin e grave, ky ligj duhet të parasheh përfaqësim gjinor më të mirë në kabinet qeveritar. Ne propozojmë që ky ligj të ketë dy dispozita që janë të realizueshme dhe të nevojshme për çdo qeveri që formohet.

Së pari, duke marrë përbazë sfidat e përfaqësimit gjinor në kabinet qeveritar, probleme të cilat paraqiten në momentin kur krijohen koalicionet qeverisëse me shumë parti, të obligohen subjektet politike të koalicionit që çdo të tretin të emëruar për një post ministror dhe të zëvendësministrat të jetë i gjinisë së kundërt. Kjo nuk do të thotë kuotë prej 30% në kabinetin qeveritar siç mund të interpretohet. Kjo nënkuption që nëse një parti i takojnë të emërojë tre ministra, të ketë së paku një të gjinisë së kundërt, apo përgjashtë ministra të emëruar, dy të jenë të gjinisë së kundërt. Megjithatë, nëse një subjekti i takon të emërojë dy ministra, atëherë nuk e obligon që të ketë të gjinisë së kundërt, pasi kjo do të mund të përbënte sfidë të patejkalueshme për subjektet në këtë fazë të zhvillimit të tyre. Pra kuota prej 30% do të ishte në nivel të emërimit të partisë.

Së dyti, varësisht prej numrit të ministreve që caktohen me Ligjin për Qeverinë, një numër që arrin kuotën e së paku 20% të posteve ministrore duhet të sigurohet për gjininë e kundërt. Megjithatë, në shumicën e rasteve, nëse subjektet në koalicion obligohen të emërojë çdo të tretin ministër të gjinisë së kundërt, kjo kuotë prej 20% do të përbushej me automatizëm. Vetëm në raste ekstreme, kur koalicioni qeveritar do të përbëhej nga shumë parti të vogla të cilat u takojnë nga një apo dy ministri, atëherë do të paraqitej nevoja të sigurohet kuota prej 20% në nivel të gjithë kabinetit qeveritar.

- Poste të Emëruara në Drejtori Komunale

Pozitat e drejtorëve komunale janë mjaft të rëndësishme në vendimmarrjen e nivelit komunal. Njëjtë si ministritë në nivel qendror edhe drejtoritë komunale mbikëqyrin dikastere të caktuara nën kompetencë të qeverisjes komunale. Gjithashtu, njëjtë si ministritë, drejtoritë nuk janë të rregulluara me ndonjë akt të veçantë, ndërkaj Ligji për Vetëqeverisje Lokale i lenë nën diskrecionin e kryetarit të komunës. Prandaj, disa komuna më të vogla, si Deçani e Rahoveci kanë më shumë drejtori komunale se disa komuna më të mëdha, si Ferizaji e Podujeva.


Kështu që, ngjashëm si për kabinetin qeveritar, propozojmë që drejtoritë komunale të rregullohen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe numri i drejtorive për një komunë të rregullohet në bazë të numri të ulëseve në kuvend komunal (i cili është i rregulluar për secilën komunë në bazë të numrit të popullsisë). Në këtë vijë të rregullimit të drejtorive komunale të sigurohet përfaqësim më i mirë gjinor. Meqë në nivel lokal kompletimi i degës së ekzekutivit bie plotësisht mbi përgjegjësinë e kandidatit fitues të Zyrës së Kryetarit, kuota minimale për drejtori duhet të caktohet në bazë të numri të drejtorive që do t'i ketë një komunë.

Për komunat që kanë 15 apo 19 ulëse në kuvend të rregullohet që ato të kenë pesë drejtori komunale dhe së paku dy nga to të janë të gjinisë së kundërt. Për komunat që kanë 21, 27 apo 31 ulëse në kuvend të kenë 9 drejtori komunale, ku së paku tre nga to të janë të gjinisë së kundërt. Për komunat që kanë 35, 41 apo 51 ulëse në kuvend të rregullohet që ato të kenë 12 drejtori komunale dhe së paku katër nga to të udhëhiqen nga gjinia e kundërt. Kjo është ngjashëm me kuotën gjinore prej 30% në drejtori komunale gjë që është e realizueshme.

Anekset


- Gratë e Emëruara në Kryesinë e Kuvendit

Kryesia e Kuvendit të Kosovës
(Përberja Gjinore)



- Shefet e Grupeve Parlamentare

Shefat e grupeve parlamentare



Bibliografia

- Intervistat

- 1. Interview personale me Albulena Balaj (Nisma). Deputete në Kuvend të Kosovës. 22.11.2018;*
- 2. Interview personale me Besa Gaxherri (LDK). Deputete në Kuvend të Kosovës. 13.11.2018;*
- 3. Interview personale me Fitneta Bejta (AAK). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 14.11.2018;*
- 4. Interview personale me Jeta Rafuna (LDK). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 09.11.2018;*
- 5. Interview personale me Kumrije Ramadani (PDK). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, PDK. 14.11.2018;*
- 6. Interview personale me Leonora Shabani Bajraktari (LVV). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 12.11.2018;*
- 7. Interview personale me Lirije Kajtazi (LDK) . Deputete në Kuvend të Kosovës. 13.11.2018;*
- 8. Interview personale me Mimoza Sylejmani (PSD). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 13.11.2018;*
- 9. Interview personale me Shqipe Pantina (PSD). Deputete në Kuvend të Kosovës. 08.11.2018;*
- 10. Interview personale me Valbone Ferati (LDK). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës. 12.11.2018;*
- 11. Interview personale me Visare Gorani (PSD). Anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës. 14.11.2018;*

- Burime tjera

12. Akademia e Grave për Lidership (AGL). (Pa) Barazia Gjinore në vendimarrje në nivel lokal. Maj 2018. <https://goo.gl/bAsAzt>
13. Democracy Plus. Vëmendje Angazhimit Qytetarë: Mangësitë dhe Mundësitë.
14. EU Observation Mission. "Preliminary Statement: Two faces of Kosovo municipal elections" (24 tetor, 2017). <https://goo.gl/DGYaoS> Shikuar më: 12 nëntor, 2018.
15. iNews. Meet the new female mayors of Europe's major cities (20 qershori, 2016) <https://goo.gl/7hWZWt> Shikuar më: 15 nëntor, 2018.
16. National Democratic Institute (NDI). Kosova: Tejkalimi i pengesave për pjesëmarrjen politike të grave. Shkurt, 2015. <https://goo.gl/ZFTx5M>

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

32-055.2

Bakija, Jetmir

Jepja shansën gruas në politikë : përmës pozitave
udhëheqëse / Jetmir Bakija. – Prishtinë : Democracy
Plus, 2019. - 30 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-758-10-9

ISBN 978-9951-758-10-9



9 789951 758109